

## Autoritetet dështuan që në mënyrë adekuate të përmirësojnë mangësitë zgjedhore

SHKUP, 28 mars 2005 – Përderisa raundi i dytë i 27 marsit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë në të shumtën e vendeve rrodhi mirë, përsëri në disa rajone nuk përmbushi përgjegjësitë dhe standardet kyçe të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës për zgjedhje të cilat kërkojnë garancë univerzale dhe të drejtë të barabartë si dhe sigurim të fshehtësisë e privatitetit të votimit. Në periudhën mes dy raundeve të zgjedhjeve lokale si dhe në ditën e votimit, autoritetet dështuan të përmirësojnë në mënyrë adekuate mangësitë e procesit zgjedhor të cilat u identifikuan në raundin e parë edhe përkundër disa tentimeve për përmirësim të tyre.

Ky është konkludimi i Misionit Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i cili shpalli sot rezultatet e tij. Rreth 260 vëzhgues nga 31 shtete kanë vëzhguar rrethin e dytë të zgjedhjeve në emër të Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (OSCE/ODIHR). Ata ishin të shoqëruar nga përfaqësues të Këshillit të Kongresit të Evropës për Kompetenca Lokale dhe Rajonale.

“Përderisa në përgjithësi një rrjedhë e mirë e votimit në një pjesë të madhe të vendit në rrethin e dytë ishte e mirëseardhur, parregullësitë e vazhdueshme në shumë vende ngrisin brengë serioze e cila kërcnon integritetin e procesit zgjedhor në tërësi dhe duhet të trajtohen si çështje urgjente,” tha Julian Peel Yates, Shef i Misionit të OSBE/ODIHR-së.

Keith Whitmore, Shef i delegacionit të Këshillit të Kongresit të Evropës tha: “Ne dënojmë diskriminimin de facto të femrës në shumë rajone si dhe mungesën e saj në Këshillat Zgjedhore dhe vendvotime, në të cilat nuk kishte prezencë të femrës. Është kruciale që të gjithë qytetarët të përfaqësohen në mënyrë adekuate nëpër institucionet e zgjedhura dhe zyrtare si dhe të respektohet e drejta e çdo qytetari për të votuar.”

Raundi i dytë i zgjedhjeve u mbajt në 57 komuna të vendit. Mes dy raundeve vëzhguesit vlerësuan se është respektuar afati ligjor për shpalljen e rezultateve preliminare dhe afati për t’iu përgjigjur ankesave. Sidoqoftë, mos shpallja e rezultateve në kohë të duhur në disa komuna dobësojnë besimin e përgjithshëm në rezultate. Raportet për kërcënim të autoriteteve zgjedhore dhe personave të tjerë, si dhe dhuna sporadike mbi aktivistët partiak kanë kontribuar në krijimin e një atmosfere negative.

Autoritetet bënë disa përpjekje për t’i përmirësuar mangësitë nga raundi i parë duke zëvendësuar Këshillat Zgjedhore në vendet ku votimi është treguar si problematik në raundin e parë, si dhe ka inicuar hetime kundër personave të përfshirë në mashtrimet zgjedhore. Mirëpo, autoritetet nuk vepruan në mënyrë konstante për t’i parandaluar rastet e keqpërdorimit të hapur dhe në shumë raste Komisionet Komunale Zgjedhore në lidhje me ankesat e nënshtruara kanë votuar ekskluzivisht në bazë të interesave partiake.

Mungesa e vazhdueshme e intervenimeve më efektive nga ana e autoriteteve relevante të drejtuara kundër kërcënimeve ndaj votuesve dhe anëtarëve të këshilleve zgjedhore ka krijuar një kulturë të mosdënit në disa komuna, duke zvogëluar kështu besimin tek zbatimi i ligjit dhe aftësinë e organeve zgjedhore për të mbrojtur legjitimitetin e procesit.

Dita e votimit në përgjithësi rrodhi në mënyrë të duhur në të shumtën e vendit. Sidoqoftë, vëzhguesit raportuan çrregullime serioze në një numër të konsiderueshëm të komunave, kryesisht ato komuna ku kishte çrregullime edhe në raundin e parë. Këto çrregullime përfshijnë vjedhje të fletvotimeve, mbushje të kutive, kërcënime, votim grupor, votim për dikë tjetër, dhe nënshkrime identike në listën e votuesve. Fshehtësia e votimit nuk u respektua në 17 përqind të rasteve dhe së paku 30 raste të mbushjes së kutive janë raportuar. Numërimi i votave u vlerësua negativisht në një nga katër vendvotime të vizituara nga vëzhguesit.

